



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 01-60/23021/25
Kaçanik, 08.12.2025

Në bazë të Vendimit për Certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale 2025 për Kryetar të Komunës Kaçanik, Nr.01/3479-2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pas dhënies së Betimit dhe Nënshkrimit të Deklaratës Solemne të Kryetarit të zgjedhur të Komunës së Kaçanikut, Sabedin Vishi sipas nenin 57.1 të LVL, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 08 dhjetor 2025, konstatoj

**INAUGURIMIN (KONSTITUIMIN) E KRYETARIT TË
KOMUNËS SË KAÇANIKUT, SABEDIN VISHI**

**(i zgjedhur në Zgjedhjet Lokale të 12 tetorit 2025,
respektivisht në Rundin e dytë të votimit të datës 09 nëntor 2025)**

1. INAUGUROHET (KONSTITUOHET) Organi më i Lartë Ekzekutiv i Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës- SABEDIN VISHI, nga subjekti politik i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së), i zgjedhur në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 12 Tetor 2025- respektivisht në Rundin e dytë të votimit me 09 Nëntor 2025, për me udhëhequr Komunën e Kaçanikut, për mandat 4 vjeçar.
2. Kryetari i zgjedhur i Komunës së Kaçanikut, me dhënien e Betimit dhe Nënshkrimit të Deklaratës Solemne para Kuvendit të Komunës dhe qytetarëve të kësaj komune, ngarkohet me përgjegjësi për ta përfaqësuar Komunën e Kaçanikut, duke vepruar në emër të saj, dhe përgjegjësitë tjera të përcaktuara si në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe akteve tjera nënligjore.
3. Kryetari i zgjedhur i Komunës së Kaçanikut, Sabedin Vishi, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të rundit të dytë të votimit të datës 09 Nëntor 2025, respektivisht pas dhënies së betimit për Kryetar komune, e merr zyrtarisht detyrën për të udhëhequr më Komunën e Kaçanikut për mandat 4 vjeçar, ndërsa e përfundon sipas nenit 56.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
4. Kompensimi për kryetarin e komunës bëhet sipas akteve në fuqi që e rregullojnë çështjen e kompensimit të pagave në sektorin publik.
5. Kryetari i deritanishëm Besim Ilazi, me datën 08.12.2025, e përfundoj mandatin 4 vjeçar sipas nenit 56.3 (a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
6. Pranim dorëzimi i detyrës zyrtare bëhet me akt ceremonial në mes kryetarit të deritanishëm të komunës Besim Ilazi dhe Kryetarit të zgjedhur të komunës Sabedin Vishi, i cili e merr mandatin për me udhëhequr me Komunën e Kaçanikut.
Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, Udhëheqësi i Personeli, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Mbledhjes
Xhelal Dema





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Data	08.12.25	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	
		Shtojcë	

Bazuar në nenin 57 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kryetari i zgjedhur i Komunës, e jep Betimin ose Deklaratën Solemne, para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 08 Dhjetor 2025, si në vijim.

BETIM

Unë, SABEDIN VISHI, "Betohe (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtrojë kompetencat si Kryetar i Komunës së Kaçanikut, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë".

Vendi, Kaçanik

Datë, 08.12.2025 2025


Emri dhe mbiemri i Kryetarit të Komunës së Kaçanikut,

SABEDIN VISHI Nënshkrimi [Signature]



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK

PRISTINE



Data 02.12.2025 Vendi Kaçanik
Nj. org. Numri Shitje
01-013/01-29597/25

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 paragrafi 2.8, nenin 106 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 9 paragrafi 5 dhe nenin 26 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 27.11.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale 2025 për Kryetar Komune në Kaçanik

- I. Pas përfundimit të procedurave në vendvotime, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), si dhe pas shqyrtimit të të gjitha ankesave që u përkasin shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale për kryetar komune, janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Gjykata Supreme e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës të raundit të dytë për Kryetar Komune, të mbajtura më 9 nëntor 2025.
- II. Kryetar Komune në Kaçanik është zgjedhur z. **Sabedin Vishi** nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës-PDK", me 7,709 vota, në përqindje prej 51.19% të votave.
- III. Rezultatet e zgjedhjeve si në pikën I, janë bashkangjitur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij. Po ashtu këto rezultatet janë përfundimtare dhe detyruese.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së që t'i publikojë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në pajtim me këtë vendim.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 27.11.2025

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

Kaçanik | Kacanik

Raundi i Dytë i Zgjedhjeve për Kryetar Komune 2025 | Drugi Krug Izbora za Gradonacelnika 2025

SABEDIN VISHI

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK

7,709 vota

51.19%

JETON RAKA

Lëvizja VETËVENDOSJE!

7,350 vota

48.81%